



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë, më, 11.03.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROPOZIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROPOZIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP)."

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, mori në shqyrtim propozimin e Këshillit të Ministrave "Për propozimin e Znj. Xhoana Lilaj si anëtare të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare" në mbledhjen e tij të datës 11.03.2019.

E pranishme në këtë seancë për të bërë një prezantim të eksperiencës së saj dhe vizionit të saj mbi veprimtarinë e AKEP-së ishte Zonja Lilaj.

Komisioni caktoi relator për këtë çështje Zotin Rakip Suli.

- ***Baza ligjore***

Projektvendimi "Për propozimin e Znj. Xhoana Lilaj si anëtare të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare" është propozim i Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektvendimi kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi***

Këshilli Drejtues i AKEP-së përbëhet nga pesë anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi, me propozim të Këshillit të Ministrave, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Në kushtet kur një anëtar i Këshillit Drejtues të AKEP-së i ka përfunduar mandati, Këshilli i Ministrave, në cilësinë e organit propozues, mbështetur në nenin 114, pika 3, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe pas njoftimit zyrtar të bërë nga Kuvendi i Shqipërisë, ka depozituar pranë Kuvendit të Shqipërisë, VKM nr.48 datë 30.01.2019,”Për propozimin e Znj. Xhoana Lilaj si anëtare të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Znj. Lila propozohet për herë të parë për të qenë pjesë e këtij Këshilli Drejtues.

- ***Diskutimi në komision***

Znj. Xhoana Lilaj, ka kryer studimet në Universitetin e Studimeve të Barit, Itali, gjatë periudhës tetor 2004 – korrik 2009 në Fakultetin “Jurisprudencë” Dega – “ Drejtësi”, duke u diplomuar me Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë, njehsuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencave.

Në karrierën e saj profesionale në fushën e drejtësisë ka kryer funksione të ndryshme dhe ka përvojë si në sektorin publik edhe në atë privat. Gjithashtu Znj.Lilaj ka qenë edhe lektore pranë Universitetit “Luarasi”, Tiranë (mars 2012 - mars 2013).

Komisioni gjatë seancës dëgjimore u njoh me CV-në e Znj.Lilaj, me vizionin e saj lidhur me institucionin e AKEP-së, si dhe në lidhje me sfidat e këtij institucioni në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare. Znj.Lilaj iu përgjigj edhe pyetjeve të bëra nga deputetët e Komisionit.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi që kandidatura e propozuar nga Këshilli i Ministrave është në përputhje me kërkesat ligjore të nenit 114, pika 4 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Rakip SULI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar